

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2740 Prot.
23

Durrës më, 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 159, datë 21.11. 2025

PËR

**"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E REVISTËS
SHKENCORE UNIVERSITARE "INTERDISCIPLINARY JOURNAL OF
RESEARCH AND DEVELOPMENT", NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; referuar shkresës Nr. 2006/4 prot., datë 22.10.2025 të Drejtorit të Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë, si dhe referuar shkresës Nr. 2006/5 prot., datë 13.11.2025 të Drejtorisë Juridike, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores për funksionimin e Revistës Shkencore Universitare "Interdisciplinary Journal of Research and Development", në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtori i Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë
 - Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

DRAFT- RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E REVISTËS SHKENCORE UNIVERSITARE
"INTERDISCIPLINARY JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT"
NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

*Miratur me Vendimin Nr. 159 datë 21/11/2025 të Senatit Akademik të Universitetit
"Aleksandër Moisiu" Durrës*

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim ofrimin e kornizës ligjore dhe operative për organizimin, funksionimin, financimin, strukturën editoriale, procedurat e botimit dhe standardet etike të Revistës Shkencore Universitare "Interdisciplinary Journal of Research and Development" (IJRD) në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD). Ajo synon të sigurojë respektimin e standardeve të larta akademike dhe etike, në përputhje me rregulloret e UAMD-së, veçanërisht nenin 34, pika 4, i cili parashikon rregullimin e veçantë të revistës për shkak të kompleksitetit dhe specifikave të saj.

Rregullorja harmonizohet me standardet ndërkombëtare të publikimeve shkencore, duke ndjekur parimet e Komitetit të Etikës së Botimit (COPE), për të garantuar transparencë, integritet shkencor dhe akses të hapur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore, mbështetet në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 35/2016, "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të", për mbrojtjen e pronësisë intelektuale; Ligjin nr.124/2024, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në përputhje me Rregulloren Europiane GDPR (Reg. (EU) 2016/679); Parimet e COPE (Komiteti i Etikës së Botimit); Licencën e Creative Commons (CC BY 4.0) për shpërndarjen e materialeve shkencore; Planin e Zhvillimit Strategjik 2025-2030 UAMD, miratuar me vendimin nr.58 dt. 18.12.2024 nga Senati Akademik; Kodin e Etikës në Kërkimin Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Neni 3

Objektivat e rregullores

Rregullorja përcakton rolin dhe kompetencat e organeve drejtuese, bordit editorial, sekretariatit administrativ si dhe strukturën e përmbajtjen e revistës, standardet teknike dhe procedurat e botimit. Objektivat e rregullores janë nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, rritja e impaktit akademik përmes indeksimit në platforma globale dhe integrimi i kërkimit shqiptar në hapësirën ndërkombëtare.

KREU II

REVISTA SHKENCORE

Neni 4

Statusi i revistës

1. Revista "Interdisciplinary Journal of Research and Development" (IJRD) është revistë shkencore ndërdisiplinore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, e cila menaxhohet dhe publikohet nga Qendra për Kërkim dhe Ekselencë.
2. Revista është publikuar për herë të parë në vitin 2014, me periodicitet dy numra standard në vit, dhe prej vitit 2022 vijon me periodicitet tre numra standard në vit, Mars, Korrik, Nëntor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

3. Revista publikon numra specialë (*special issue*), ku përmbledhen punime të Konferencave Ndërkombëtare të organizuara nga Fakultetet e UAMD-së.
4. Revista është e pajisur dhe identifikohet me ISSN të vlefshëm: ISSN 2410-3411 dhe E-ISSN 2313-058X.
5. Revista është e anëtarësuar në platformën digjitale *Publishers International Linking Association Crossref* dhe është e pajisur me DOI (*Digital Object Identifier*), ku çdo artikull i publikuar identifikohet me një DOI të veçantë dhe me anë të tij bëhet ndërlidhja e referencave me artikullin e publikuar.
6. IJRD është e indeksuar në bazat e të dhënave dhe platformat ndërkombëtare si: *Google Scholar*; *Dimensions*; *EBSCO Discovery Service*; *CNKI Scholar*; *Baidu Scholar*; *J-Gate*; *JournalTOCs*; *Microsoft Academic (legacy)*; *MyScienceWork*; *KESLI-NDSL*; *CNPIEC – cnpLINKer*; *Naviga (Softweco)*.

Neni 5

Objektivat e revistës

1. Promovimi i kërkimeve të reja shkencore, studimeve të rasteve dhe zhvillimeve intelektuale origjinale në fusha ndërdisiplinore.
2. Botimi i revistës në përputhje me standardet ndërkombëtare të publikimeve akademike.
3. Të kontribuojë në rritjen e impaktit akademik të UAMD-së, përmes indeksimit në platforma ndërkombëtare të njohura si Scopus, Web of Science etj.
4. Të sigurojë një platformë me akses të hapur online, për shkëmbimin global të punimeve shkencore mes akademikëve, studiuesve, ekspertëve të fushës dhe kërkuesve të rinj.

Neni 6

Organet drejtuese të revistës

1. Kryeredaktori/Redaktorët
2. Bordi Editorial/Recensentët
3. Drejtori i QKE/Sekretariati Administrativ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Neni 7

Kryeredaktori/redaktorët

1. Revista drejtohet nga Kryeredaktori, i cili caktohet nga Drejtori i QKE-së me miratimin e Bordit Këshillimor të UAMD-së.
2. Kryeredaktori miraton paraprakisht artikujt e mbërritur për botim dhe ua dërgon redaktorëve për vlerësim të mëtejshëm.
3. Ai siguron cilësinë shkencore të punimeve dhe mbikëqyr procesin e recensës.
4. Në koordinim me sekretariatit administrativ, kryeredaktori, jep miratimin final për publikimin e numrit të revistës.

Neni 8

Bordi editorial

1. Bordi editorial përbëhet nga akademikë dhe profesorë të shquar brenda dhe jashtë vendit.
2. Anëtarët e Bordit editorial ftohen nga Kryeredaktori dhe Drejtori i QKE, bazuar në ekspertizën akademike dhe kontributin e tyre në fusha ndërdisiplinore. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me mundësi rinovimi.
3. Bordi editorial vendos për politikat editoriale, siguron cilësinë shkencore dhe promovon revistën në arenën ndërkombëtare.
4. Recensentët përzgjidhen përmes thirrjes për kontribut shkencor që IJRD shpall herë pas here në platforma të ndryshme digjitale.
5. Recensentët e revistës janë profesorë apo studiues me grada dhe tituj akademikë, brenda dhe jashtë vendit, të apasionuar pas kërkimit shkencor, të cilët japin kontributin e tyre, sipas fushave të ekspertizës.

Neni 9

Drejtori i QKE/Sekretariati administrativ

1. Revista menaxhohet dhe publikohet nga Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE).
2. Drejtori i QKE, mbikëqyr dhe menaxhon procesin editorial të revistës.
3. Kryeredaktori dhe Drejtori i QKE-së bashkëpunojnë për garantimin e cilësisë shkencore, promovimin ndërkombëtar dhe zhvillimin strategjik të revistës.
4. Sekretariati administrativ (Zyra editoriale dhe e publikimit) është përgjegjës për mirëadministrimin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit editorial.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

5. Sekretariati administrativ menaxhon marrjen në dorëzim, komunikimin me autorët, përgatitjen teknike, formatimin, arkivimin digjital të artikujve dhe botimin e numrave të revistës.

KREU III

STRUKTURA DHE STANDARDET E REVISTËS

Neni 10

Përmbajtja e revistës

1. Revista pranon punime akademike që plotësojnë standarde të larta nga të gjitha fushat e shkencës, përfshirë, por jo kufizuar, në:
 - Shkenca Shoqërore dhe Humane
 - Shkenca Natyrore dhe të Aplikuara
 - Inxhinieri dhe Teknologji
 - Ekonomi dhe Biznes
 - Arsime dhe Shkenca Humane
 - Shkencat e Shëndetit dhe Studimet Mjedisore
2. Revista publikon punime shkencore origjinale, studime rasti, rishikim literature, studime kërkimore specifike si dhe punime të konferencave të fakulteteve të UAMD-së.
3. Revista publikohet vetëm në gjuhën angleze dhe është pa pagesë.
4. Revista është me akses të hapur (*open access*) për të gjithë autorët, kërkuesit shkencorë, studiuesit, studentët etj., brenda dhe jashtë vendit.

Neni 11

Elementët teknikë të punimeve shkencore

1. Punimi shkencor duhet të përmbajë:
 - Titullin e punimit, i cili duhet të jetë sintezë e problematikës që trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere;
 - Emër Mbiemër të autorit/ëve si dhe Institucioni ku punon;
 - Abstraktin i cili duhet të përmbajë rreth 150-250 fjalë, si dhe fjalët kyçe (5-7);
 - Hyrjen, metodologjinë, rezultatet e kërkimit, diskutimet, përfundimet, falenderimet, referencat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

2. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtreron. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë "Hyrja", në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij. Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me "**Bold**" dhe shkrim "*Italic*" "*Times New Roman 12*". Datat shkruhen sipas modelit: data, muaji, viti, ndërsa titujt e nënçështjeve paraprihen nga numrat 1.1, 2.1, 3.1 etj.
3. Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: sugjerimet apo konkluzionet. Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe bibliografinë/ referencat. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 15 referenca.
4. Gjatësia e punimit duhet të jetë minimumi 3000 fjalë dhe maksimumi 8000-9000 fjalë (pa abstraktin, tabelat, figura dhe referenca).
5. Shkrimi i artikullit duhet të jetë "*Times New Roman font 12*" me "*Hapësirë 1*" dhe i gjithë teksti të jetë "*Justify-ed*".
6. Hapësira e rreshtave: Hapësirë e vetme në të gjithë punimin, duke përfshirë faqen e titullit, abstraktin, trupin e dokumentit, referencat, shtojcat, fusnotat, tabelat dhe figurat.
7. Margjinat: 1 inç (2,54 cm) në të gjitha anët (sipër, poshtë, majtas, djathtas)
8. Gjuha e punimeve është anglisht (amerikane ose britanike), me stil formal dhe gjuhë sa më e qartë nga ana gramatikore.
9. Citimet në tekst dhe referencat ndjekin stilin APA (American Psychological Association), (Field, 2005); (Field, 2005, p. 14).
10. Lista e referencave renditet sipas rendit alfabetik në fund të artikullit.

KREU IV

PROCESI I PRANIMIT, VLERËSIMIT DHE BOTIMIT

Neni 12

Procesi i pranimit dhe vlerësimit

1. Dorëzimi i punimeve bëhet në formë elektronike në adresën e email-it të revistës ijrd@uamd.edu.al.
2. Redaktori fillimisht vlerëson nëse punimi është i përshtatshëm për revistën, nëse jo, punimi refuzohet dhe autori njoftohet për shkaqet e refuzimit.
3. Të gjitha punimet e pranuar për shqyrtim i nënshtrohen kontrollit antiplagjiaturë përmes sistemit Turnitin/ iThenticate dhe më pas kalojnë në procesin e recensës (blind peer review). Procesi i kontrollit të plagjiaturës siguron integritetin shkencor të revistës, duke garantuar që të gjitha punimet e botuara janë origjinale dhe respektojnë standardet etike të kërkimit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

4. Recensentët, të përzgjedhur sipas ekspertizës së tyre shkencore, japin vlerësimin në mënyrë të paanshme dhe profesionale mbi saktësinë shkencore, origjinalitetin dhe rëndësinë shkencore të punimit, duke rekomanduar në fund: pranim të punimit, pranim me ndryshime të vogla, pranim me ndryshime madhore dhe refuzim.
5. Kohëzgjatja e procesit të recensës zgjat nga 4 deri në 7 javë që nga dorëzimi i punimit.
6. Rezultatet e vlerësimit i komunikohen në formë elektronike autorit, përfshirë komentet e recensentëve për përmirësim, nëse ka, apo arsyet e refuzimit, duke i përcaktuar një afat maksimal prej dy javësh për rishikim të punimit.
7. Kryeredaktori/redaktori miraton në përfundim të procesit vlerësues të gjitha punimet e pranuar për botim.

Neni 13

Arsyet për refuzimin e punimit shkencor

1. Mospërputhje me fushën e revistës ose standardet akademike.
2. Cilësi e ulët shkencore, metodologjike ose gjuhësore.
3. Mungesë origjinaliteti ose plagjiaturë (mbi lejueshmerinë e citimeve të lejuara nga Turnitin/iThenticate).
4. Konfliktet e interesit të padeklaruara ose shkelje etike.
5. Publikim i mëparshëm ose dorëzim paralel në revista të tjera.

Neni 14

Kontrolli i plagjiaturës

1. Të gjitha punimet shkencore të pranuar për botim në revistën IJRD i nënshtrohen një kontrolli të rreptë për plagjiaturë përmes softuerit Turnitin/iThenticate, përpara fillimit të procesit të recensës.
2. Lejueshmëria e ngjashmërive, sipas raportit të gjeneruar nga iThenticate, është nën 20%. Nëse niveli i ngjashmërisë tejkalon këtë prag, punimi mund të refuzohet automatikisht ose t'i kërkohej autorit të kryejë rishikime për të adresuar çështjet e identifikuara, në varësi të natyrës dhe shkallës së ngjashmërisë.

Neni 15

Procesi i botimit

1. Pas miratimit final për publikim të të gjitha punimeve të pranuar, ato i nënshtrohen procesit të formatimit, sipas standardeve të përcaktuara dhe formatit të revistës.
2. Të gjitha punimet publikohen online, në numrin përkatës të revistës, ku çdo artikull i publikuar identifikohet me një DOI të veçantë, duke mundësuar kështu aksesimin, në çdo kohë dhe nga të gjithë të artikullit të publikuar.
3. Revista IJRD publikohet me një periodicitet tre herë në vit, në fund të muajit Mars, Korrik, Nëntor.

KREU V

AUTORËSIA, E DREJTA E PRONËSISË DHE ETIKA E BOTIMIT

Neni 16

Politika e etikës së botimit

1. Revista IJRD zbaton parimet e Komitetit të Etikës së Botimit (COPE), duke respektuar standardet ndërkombëtare për transparencë, integritet dhe praktikën më të mira në botimet shkencore.
2. Redaktorët janë të detyruar të garantojnë paanshmërinë në procesin e vlerësimit, konfidencialitetin e materialeve të dorëzuara dhe menaxhimin e çdo konflikti interesi që mund të lindë gjatë procesit editorial.
3. Autorët duhet të sigurojnë që punimet e tyre janë origjinale, të pashpërndara më parë dhe pa përmbajtje plagjiature, si dhe, të deklarojnë qartë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në interpretimin ose paraqitjen e rezultateve kërkimore.
4. Recensentët mbajnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të materialeve që u dërgohen për shqyrtim, duke siguruar vlerësim objektiv dhe profesional.
5. Çdo shkelje e parimeve etike trajtohet nga redaksia në përputhje me politikat e COPE dhe mund të sjellë masa si:
 - tërheqje zyrtare e artikullit,
 - njoftim formal publik,
 - refuzim i botimit të ardhshëm për një periudhë të caktuar.

Neni 17


Autorësia dhe e drejta e pronësisë

1. Autorësia i atribuohet vetëm atyre individëve që kanë dhënë një kontribut thelbësor në konceptimin, dizajnin, ekzekutimin ose interpretimin e studimit. Kontributet e tjera ndihmëse mund të njihen në rubrikën "Falenderime".
2. Pas pranimi të punimit për botim, autorët, automatikisht, përmes Marrëveshjes së Transferimit të Autorsisë (CTA), transferojnë të drejtën e botimit tek revista IJRD, duke ruajtur të drejtat morale mbi veprën e tyre dhe duke e shpërndarë nën licencën Creative Commons Attribution (CC BY 4.0).
3. Autorët kanë të drejtë të shpërndajnë versionin final të botuar në faqet e tyre personale, në arkiva institucionale apo rrjete kërkimore (p.sh. ResearchGate, Academia.edu), duke cituar burimin original të botimit dhe DOI-n përkatës.

Neni 18

Politika e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave

1. Revista IJRD respekton Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), duke mbledhur dhe përpunuar vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për procesin editorial (emër, mbiemër, tituj akademikë/shkencorë, institucion, shtet dhe adresë kontakti).
2. Të dhënat personale të autorëve, recensentëve dhe redaktorëve përdoren ekskluzivisht për qëllime komunikimi dhe administrimi editorial dhe nuk shpërndahen tek palë të treta, përveç rasteve të kërkuara nga ligji ose autoritetet përkatëse.
3. Revista garanton ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave në mënyrë të sigurtë dhe për një periudhë të kufizuar kohore, në përputhje me politikat institucionale të mbrojtjes së të dhënave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Interpretimi i rregullore

Të drejtën e interpretimeve dhe ndryshimeve në këtë rregullore e ka vetëm Senati Akademik. Për të gjithë situatat të cilat nuk gjejnë përgjigje në këtë rregullore, vihen në zbatim dispozitat e përcaktuara në statutin dhe në rregulloren e UAMD-së.

Neni 20

Zbatimi i rregullore

Kjo rregullore zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe për një kohë të pacaktuar nga strukturat e ngarkuara, menjëherë pas miratimit të saj.

Neni 21

Miratimi i rregullore

1. Rregullorja e revistës IJRD miratohet në Senatin Akademik dhe është objekt i përmirësimit të vazhdueshëm. Ndryshimet duhet të synojnë përmirësimin e rregullave ekzistuese apo plotësimin me rregulla të reja për situata që nuk janë normuar nga kjo rregullore, por që janë objekt i saj.
2. Ndryshimet e propozuara në këtë rregullore miratohen në Senatin Akademik të UAMD-së.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i UAMD-së.